

Sistemi shëndetësor

Sistemi shëndetësor në Zvicër është shumë mirë i ndërtuar. Të gjithë banorët janë të siguruar në mënyrë të plotë dhe të detyrueshme kundër aksidenteve dhe sëmundjeve. Shumë ordianca mjekësore, barnatore dhe spitale ofrojnë shërbime të sigurta kujdesi.

Sistemi i sigurimeve

Në Zvicër, të gjithë banorët duhet të jenë të siguruar kundër aksidenteve dhe sëmundjeve. Kushdo që iu bashkohet, duhet ta bëjë sigurimin brenda tre muajve prej hyrjes në vend. Fëmijët duhet të sigurohen brenda tre muajve prej lindjes. Shërbimet e sigurimeve të detyrueshme janë të rregulluara me ligj. Të gjithë të sigurvekë kanë të drejtë për përkujdesje të njëjtë mjekësore.

Financimi

Sistemi shëndetësor zviceran financohet bashkarisht nga shteti (federata, kantonet, komunat), punëdhënësit dhe personat privatë. Personat privatë bëjnë një pagesë mujore për sigurimin shëndetësor dhe aksidental. Kjo shumë caktohet çdo vit dhe ndryshon sipas kantonit. Kush sëmuret ose aksidentohet, duhet të bëjë pagesa shtesë (franshiza dhe pjesa vetanake - Franchise und Selbstbehalt). Këtu ka një shumë maksimale vjetore.

Përkthimet

Nuk është e lehtë kur duhet të flitet me mjekë, farmacistë ose infermierë në një gjuhë të huaj. Prandaj, disa spitale ofrojnë përkthime falas nga përkthyes të trajnuar veçanërisht për përkthime ndërkulturore. Pacientët duhet të informojnë vetë me kohë rreth kësaj. Përkthyesit mund të rezervohen për vizita mjekësore ose situata të tjera edhe vetë, por atëherë duhet paguar nga vetë pacientët.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

dev.hallo-aargau.ch/sq/shendeti/sistemi-shendetesor